

Terroristi që kreu masakrën e fundit në Zelandën e Re, në manifestin e tij të shkruar, ku ?përligjte krimin nga pikëpamja e tij etno-raciste, kishte përdorur për gati njëzetegjashtë herë ?fjalën "pushtues" (invaders). Këta pushtues -sipas tij- ishin të gjithë ata njerëz jo të bardhë, jo ?evropian që me emigrimin dhe shtimin e tyre demografik po pushtonin Perëndimin! Ai thotë se ?raca e tij është vënë në rrezik nga këta "pushtues" me ngjyrë që po i "uzurpojnë" atij tokën e të ?parëve të tij! Kështu që për të ky veprim ishte një akt "çlirimi" dhe vetja i dukej si një "partizan ?çlirimtar", që po i hapte sytë Evropës dhe Perëndimit, nga rreziku që i kanoset. Ai thotë se ?politika e diversitetit është dobësi ndërsa uniteti etno-racor dhe kulturor është fuqi. ?

Mes emrave të shumtë, që ai kishte zgjedhur si heronj të tij këtij modeli të çlirimit nga ?pushtuesit e huaj, ishte edhe emri "Skanderbeg" i shkruar mbi armën e tij të krimit! Gjithkush ?mund të thotë se ky është një keqpërdorim i një njeriu të papërgjegjshëm dhe ne nuk kemi pse ?ta ngatërrojmë heroin tonë kombëtar me aktin monstruoz të një terroristi. Po kjo është e ?vërtetë, por ajo që na intereson ne këtu nuk është vetë Skënderbeu, dhe se çfarë ka bërë ai, por ?se kush e frymëzoi dhe nga i erdhi ideja këtij njeriu për ta shfrytëzuar këtë figurë për "kauzën" ?e tij? Padyshim, ne e dimë mirë, se këtë dimension kriminal kundra muslimanëve ia japin sot ?kësaj figure, emra të njohur në trevat shqiptare, si studiues, gazetarë, klerikë etj. Kështu që kur ?Skënderbeun e përdorin vetë shqiptarët islamofob, si hero të një feje kundra një feje tjetër, nuk ?është fare habi ta përdor edhe një anglosakson terrorist, që kërkon "heronj" për kauzën e tij ?neo-fashiste.

Ne, si muslimanë, kemi vite që denoncojmë gjuhën e urrejtjes anti-muslimane që përdoret ?nëpër mediat tona, madje "vrasësi me pagesë i publicistikës shqiptare" K.Myftaraj është modeli ?më i paskrupullt i asaj, të cilën të tjerë e thonë nën zë, ose me gjuhë më të moderuar, të një ?gjenocidi anti-musliman, në të gjitha dimensionet e tij. Rrjetet sociale dhe portalet e ndryshme, ?mbushen pafund me komente anti-muslimane dhe kundra tyre nuk merret asnjë masë ndalimi. ?Teza idiote, që hasim shpesh nëpër komente, se shqiptarët muslimanë në këtë vend nuk janë ?me origjinë shqiptare, por mbetje racore e turqve, nuk është vetëm se ndikim i drejtpërdrejtë i ?kësaj fryme raciste, që i sheh të gjithë muslimanët në Evropë si të ardhur dhe pushtues. Ky ?racizëm i bardhë, që e sheh zgjidhjen te pastërtia etnike dhe kulturore e çdo vendi, harron që ?një pjesë të mirëqenies së tij e ka ngritur mbi kolonizimin ekonomik, politik e kulturor të ?vendeve të tjera me ngjyrë. Harron se shfrytëzon burimet natyrore të shumë prej këtyre ?vendeve, kundrejt çmimeve qesharake dhe ua rimerr atë duke i shitur produktet e tij shumë ?herë më shtrenjtë. Racistët e bardhë evropian harrojnë se korporatat dhe shtetet e tyre ?mbështesin regjimet kriminale të mjaft prej këtyre vendeve që ata shfrytëzojnë, dhe pasi i ?rrjepin u ofrojnë kredi për të mbajtur veten me bukë, dhe pastaj i varin gjithë jetën pas ?interesave të tyre bankare. Këto vende janë të gatshme të bëjnë edhe luftë me armë për të ?mbrojtur interesat e tyre ekonomike, por kur vjen puna për të drejtat e njeriut dhe të drejtën ?legjitime të këtyre popujve, për të përmbysur marionetat e interesave të tyre, mjaftohen me ?deklarata dhe raporte boshe. ?

Evropa dhe Perëndimi i kanë hapur dyert emigrantëve me ngjyrë, jo thjesht për shkak të ?humanizmit dhe multikulturalizmit, pikëpamje këto që padyshim i besojnë shumë evropianë, ?por edhe për shkak të nevojës së madhe që ata kanë për krah pune, për rigjallërim të popullsisë ?së tyre të plakur. Kështu që ky "pushtim me ngjyrë" i perëndimit është pasojë e drejtpërdrejtë e ?pushtimeve të tij kolonialiste ndaj këtyre vendeve si dhe e dekadencës morale të vetë ?Perëndimit, që ka sjellë si pasojë tkurrjen e tij demografike. ?

Po ne shqiptarët ku bëjmë pjesë në këtë mes?

Padyshim që ne jemi racë e bardhë evropiane, por ndërkohë shumica jonë i përkasin një feje, të cilën racistët e bardhë e konsiderojnë si fe aziatike e njerëzve me ngjyrë, dhe pikërisht për këtë, për ta ne jemi njerëzit më të urreyer -siç shprehej vrasësi australian në manifestin e tij- sepse kemi tradhtuar fenë e të parëve! Të njëjtën gjuhë dhe teza i dëgjojmë përditë edhe këtu në mesin tonë, mes shqiptarëve tanë, që befasi paskan zbuluar se bashkëkombësit e tyre musliman dhe feja islame na zhveshkan nga të qenit shqiptarë dhe evropianë madje edhe nga të qenit racë e tillë! Kështu që për më ekstremistët mes tyre, qofshin fetar ose laik, islami dhe muslimanët duhen zburar apo zhdukur nga këto troje me çdo mënyrë, ndërsa për më të moderuarit mes tyre një islam i vdekur dhe muslimanë pa identitet është zgjidhja më e mirë. Dhe të dyja palët na kanë vënë para zgjedhjes ose "shqiptar i mirë" ose "musliman i devotshëm", sepse të dyja për ta është e pamundur. Ose të bëhemi të krishterë apo laik, dhe të adhurojmë idhujmitet e tyre, ose shqiptaria jonë është e dyshimtë dhe kemi nevojë të deradikalizohemi.

Fakti që ngjarje të tilla si kjo e Zelandës së Re, nuk kanë ndodhur te ne dhe shpresojmë të mos ndodhin, kanë të bëjnë pikërisht me faktin se shqiptarët muslimanë janë autoktonë në këto troje, janë racë e bardhë, përbëjnë një shumicë të konsiderueshme dhe nuk perceptohen si racë e huaj me ngjyrë nga bashkëkombësit e tyre jomusliman. Por, ndërkohë islamofobët shqiptarë po kërkojnë me çdo kusht që racizmin e tyre kulturor ta zbrazin ndaj çdo simbolike publike të Islamit, duke i identifikuar ato njëlloj si racistët e bardhë, me ngjyrën e lëkurës së evropianëve që po "pushtojnë" Perëndimin me shtimin e prezencës së tyre. Pikërisht mbi këtë bazë simbolike-fetare, kulturore dhe tezë pseudoracore, ndërtohet sot ligjërimi islamofob shqiptar. "Skanderbeg-u" i islamofobëve shqiptar sot mund të mos vrasë njerëz me armë, por gjuha e urrejtjes që ai mbjell përditë kundra muslimanëve dhe fesë së tyre, nuk është më pak e dëmshme. Kështu që si shtetit shqiptar, si instituteve dhe ambasadave të huaja, që sponsorizojnë studime dhe projekte kundra ekstremizmit të dhunshëm, mes muslimanëve, do t'i sugjeroja të merren seriozisht edhe me islamofobinë dhe pasojat e saj të rrezikshme në shoqërinë shqiptare, nëse duan t'i paraprijnë ndalimit të krimeve të paralajmëruara për vite me radhë. Ndërkohë besimtarëve musliman do t'i bëja thirrje që t'i përballojnë këto momente të vështira, ashtu si Profeti ynë në raste të ngjashme, me lutje, maturi dhe durim, pa kaluar në vetëviktimizim qaraman dhe as shfryrje të ulëta ofenduese ndaj njerëzve dhe pa i hyrë në hak asnjërit, sepse me të vërtetë Allahu është me durimtarët.